

=====

Direktiva 2004/113 për trajtim të barabartë për burrat dhe gratë në ofrimin e shërbimeve

Dr. Senada Reçi

Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër, Shqipëri
sreci@unishk.edu.al

Dr. Gasper Kokaj

Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër, Shqipëri
gkokaj@unishk.edu.al

Abstrakti

Ky punim trajton një element të rëndësishëm, mosdiskriminimin në bazë të gjinisë në ofrimin e shërbimeve në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian. Meqenëse trajtimi i barabartë i burrave dhe grave në ofrimin e shërbimeve dhe mallrave ka hasur shpesh në kufizime e pengesa nga ana e legjislacioneve të shteteve anëtare të BE-së, Këshilli nxorri direktivën 2004/113 për të siguruar një zbatim më të barabartë dhe për të luftuar diskriminimin në ofrimin e shërbimeve mes burrave e grave. Analiza e kësaj direktive synon të evidentojë problemet që ezauron si akt dhe situatat që interpretohen më eksplicite nga vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Përfundimet e këtij punimi demonstrojnë efektet e vendimit Test-Achats me anë të të cilit GJED arriti të sjellë pasoja efikase në vendosjen e rregullave të detyrueshme në trajtimin e barabartë të burrave e grave në ofrimin e shërbimeve duke i shërbyer zbatimit korrekt të direktivës 2004/113.

Hyrje

Shërbimet janë sektor shumë i rëndësishëm në Tregun e Brendshëm të BE dhe përbëjnë bazën e punësimit dhe të të ardhurave për këtë treg. Një problem i diskutuar, i ankimuar dhe shpeshherë i përsëritur pa një zgjidhje në favor të mosdiskriminimit gender në ofrimin e shërbimeve është problemi i trajtimit të barabartë mes burrave e grave pasi aktorët e ofrimit e marrjes së këtyre shërbimeve janë të dy gjinive.

Një ndikim me vete në liberalizimin e shërbimeve, ka sjellë edhe Direktiva 2004/113/KE që përbën një akt komunitar të rëndësishëm në zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, pasi sanksionon barazinë gjinore dhe diskriminimin në bazë të seksit jashtë fushës së punësimit në nivel të Bashkimit Evropian.

Direktiva ka qëllim të ndalojë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në bazë të gjinisë në aksesin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që janë në dispozicion për publikun, në të dy sektorët publikë dhe privatë. Ajo ndalon trajtimin më pak të favorshëm të gruas për arsye të shtatzënisë dhe amësisë, si dhe ngacmimin dhe ngacmimin seksual dhe udhëzimin për të diskriminuar kudo që qarkullojnë mallra ose janë ofruar shërbime.

Baza ligjore e Direktivës është ish-neni 13 i TKE-së që parashikon marrjen e masave për diskriminimin e bazuar në seks¹¹⁸. Ky nen parashikon mundësinë e marrjes së masave komunitare për të luftuar rastet e mosdiskriminimit për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës etj. Pra institucionet komunitare detyrojnë shtetet të marrin masa për të respektuar trajtimin e barabartë mes grave dhe burrave përsa i përket ofrimit të shërbimeve e mallrave.

Direktiva 2004/113, rregullimi ligjor i saj dhe efektet e zbatimit në shtetet anëtare

Shtetet anëtare të BE kishin detyrimin deri më 21 dhjetor 2007 për të zbatuar Direktivën 2004/113 në bazë të nenit 17 të tekstit, por zbatimi u shty për më vonë si pasojë e efekteve të vendimit të GJED-së në çështjen Test-Achats¹¹⁹.

¹¹⁸ Pa cënuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe brenda kufijve të kompetencave që ato i japin Bashkimit, Këshilli duke vendosur me unanimitet sipas një procedure të posaçme legjislative, dhe pasi merr pëlqimin nga Parlamenti Evropian, mund të marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.2. Duke u shmangur nga paragrafi 1, Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duke vepruar sipas procedurës së zakonshme legjislative, mund të miratojnë parimet bazë të masave stimuluese të Bashkimit, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare, për të mbështetur masën e marrë nga shtetet anëtare, me qëllim që të jepet kontribut në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1. Shih nenin 19 TFBE (ish-neni 13 TKE) në tekstin: Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, 2008.

¹¹⁹Komisioni Evropian duhej të hartonte një raport përmbledhës për të vlerësuar zbatimin jo më vonë se 21 dhjetor 2007.Megjithatë, pas disa vonesave, Komisioni Evropian informoi raportuesin se një raport i tillë nuk do të hartohej para vitit 2014, për arsye të pasojave të rastit test-Achats që zhvendosi prioritetet dhe se ndryshimet e bëra në sektorin e sigurimeve e bëne raportin e zbatimit të parakohshëm. Per kete shih:Report on transposition and application of Council Directive 2004/113/EC

Po si ndikoi vendimi i çështjes në fjalë ndaj zbatimit të nenit 5 të direktivës?
Neni 5 parag.1 i Direktivës parashikon se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që nuk do të kishte dallime mes primeve të individëve dhe përfitimeve në fushën e sigurimeve¹²⁰. Megjithatë, me përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm (pa ndonjë kufizim kohor), neni 5 parag.2 i dha shteteve anëtare opsionin e vendosur para 21 dhjetor 2007 për të lejuar dallimet proporcionale të primeve (policave) të individëve dhe përfitimeve, ku përdorimi i gjinisë ishte një faktor përcaktues në vlerësimin e rrezeve bazuar në të dhëna të sakta dhe statistikore. Ky përjashtim ishte dhënë për të gjitha shtetet anëtare që kanë bërë derogim të përdorimit të saj në lidhje me një ose më shumë lloje të sigurimit (në veçanti në sigurimin e jetës). Megjithatë, gjykimi i Test-Achats të 1 mars 2011, e përmbysi këtë rregullim të direktivës. Rasti ka të bëjë me një shoqatë të konsumatorit belg, test-Achats, që kishte paditur qeverinë belge, duke pretenduar se masa ligjore e miratuar nga qeveria për transpozimin e Direktivës ishte kundër arritjes së objektivit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave dhe ishte e papajtueshme me nenin 21 e 23 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian¹²¹. Gjykata Kushtetuese belge kërkoi nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë një vendim paraprak për vlefshmërinë e nenit 5 (2) të Direktivës, dhe GJED vendosi në favor të test-Achats se neni 5 (2) ishte në shkelje të Kartës së të Drejtave Themelore dhe rrjedhimisht i pavlefshëm. Si pasojë, dispozita përkatëse u konsiderua të ishte e pavlefshme pas kalimit të një periudhe të përshtatshme kalimtare, respektivisht me efekt nga 21 dhjetori 2012. Megjithatë gjykata vendosi se pas periudhës tranzitore të gjitha kontratat e reja të sigurimit në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian nuk mund të përdorin gjininë për të përcaktuar pagesën e primeve të sigurimit apo dhënien e përfitimeve. Duke përdorur industrinë e sigurimeve të makinave si një shembull, duke folur statistikisht, burrat në përgjithësi janë të përfshirë në një numër më të lartë të aksidenteve të rënda dhe

implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services (2010/2043(INI))ne

<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=REPORT&reference=A7-2013-0044&language=EN>.

¹²⁰ Shih nenin 5 të Direktivës në *Official Journal of the European Union*, 21.12.2004 në <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:373:0037:0043:en:PDF>

¹²¹ Neni 21- 1. Ndalohej çdo lloj diskriminimi për shkak të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual.2. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cënuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohej çdo diskriminim për shkak të shtetësisë. Neni 23- Barazia midis grave dhe burrave garantohet në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën. Shih Kartën për të Drejtat Themelore në Bashkimin Evropian në tekstin: Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, botim i Ministrisë së Integritetit Evropian, 2008.

paraqesin pretendime më të shtrenjta sesa gratë, si rezultat, siguruesit janë justifikuar në përdorimin e këtij përjashtimi, kur bëjnë llogaritjen e çmimit të politikës të aplikantit. Prandaj, gratë tradicionalisht kanë marrë kuota të sigurimit të jetës për makinat me të lira se sa homologët e tyre meshkuj¹²².

Kjo është një shkelje e Kartës për të drejtat themelore që ndalon çdo lloj diskriminimi dhe u kërkon shteteve anëtare garantimin e barazisë gjinore në çdo fushë. Në këtë rast Gjykata e ka interpretuar direktivën në kuadër të pajtueshmërisë me Kartën e të drejtave themelore dhe kështu i ka dhënë dispozitave të kësaj të fundit karakter detyrues për vetë direktivën pasi papajtueshmëria e dispozitave të dy akteve me njëra-tjetrën shpall fituese në fund nga GJED Kartën.

Efektet e vendimit Test-Achats

Vendimi Test-achats u mirëprit nga shumë si një hap përpara për barazinë gjinore dhe për dhënien fund të praktikave të vjetëruara, por pati edhe disa polemika veçanërisht nga politikanë konservatorë të Mbretërisë së Bashkuar të cilët mendonin se gjykata kishte tejkaluar pushtetin e saj duke e bërë legjislacionin e vet.

Në fakt Gjykata e ka përdorur në rastin Volker und Marcus Schecke (vendim i vitit 2010), për herë të parë Kartën, për testimin e dispozitave 41 e 44 të Rregullores 1290/2005, por te Test-Achats nënvizoi se interpretimi i dispozitës të direktivës në dritën e Kartës bëhet pavarësisht se direktiva është miratuar përpara Kartës (që hyri në fuqi në të njëjtën datë me Traktatin e Lisbonës në 2009) pasi përbën detyrim për GJED-në që të interpretojë të drejtën e BE-së në përputhje me frymën e Kartës për të drejtat themelore të BE-së. Kjo përjasje e Gjykatës është një përpyetje e saj për të siguruar që sistemi ligjor evropian mund të mbrojë të drejtat themelore nga brenda Bashkimit, por edhe për të treguar balancën e pushteteve mes saj dhe institucioneve evropiane në lidhje me të drejtën e BE-së. Ky vendim mund të ketë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm mbi pensionet private dhe skemat e kursimit dhe të ketë në përgjithësi një ndikim për diskutim mbi mjaftueshmërinë e pensione.

Sipas Raportit të paraqitur nga PE me 25 Shkurt të vitit 2013, që ka si qëllim të vlerësojë pasojat dhe shkallën e zbatimit të Direktivës 2004/113 në Shtetet Anëtare, për të identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe për të rekomanduar zgjidhjet e mundshme, janë raportuar rastet e diskriminimit në lidhje me shtatzëninë dhe

¹²² Shih: Report on transposition and application of Council Directive 2004/113/EC implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services (2010/2043(INI)) në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=REPORT&reference=A7-2013-0044&language=EN>; Test-Achats v. Council of Ministers në http://en.wikipedia.org/wiki/Test-Achats_vs_Council_of_Ministers.

amësinë sa i përket për shembull sektorit të strehimit (qera) ose vështirësisë në marrjen e kredive, edhe sa i përket shërbimit ndaj kujdesit të ligjshëm në dispozicion të shëndetit riprodhues. Gjithashtu përmbajtja e mediave dhe reklamave, për momentin jashtë fushës së direktivës duhet të vlerësohet nga ky këndvështrim, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre fushave në lidhje me arsimin dhe rolin e madh që luajnë në krijimin, mbajtjen, ringjalljen dhe zhvillimin e stereotipeve të bazuara në gjini. Direktiva parashikon një ndryshim në barrën e provës, të paditurit duhet të provojnë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të bazuar në faktet e sjellura nga ana e viktimës. Kjo dispozitë është zbatuar në shumicën e legjislacioneve kombëtare në kontekstin e qasjes ndaj mallrave dhe shërbimeve dhe i ka dhënë vend jurisprudencës në nivel kombëtar¹²³.

Në përfundim të kësaj analize mund të themi që rëndësia thelbësore e direktivës qëndron në respektimin nga shtetet anëtare të parimit të barazisë gjinore duke ndaluar diskriminimin bazuar në gjini në mallra dhe shërbime, në dritën e ndryshimeve të direktivës të sjellë nga vendimi i Test-Achats.

Perfundime

Direktiva 2004/113 mbi barazinë gjinore që pas vendimit të Test-Achats mbi diskriminimin gjinor në primet e sigurimit të makinave, ndryshoi kuptimin e nenit 5 të saj pasi ishte në shkelje të Kartës mbi të Drejtat themelore të BE-së duke i dhënë efekt Kartës si të detyrueshme përballë akteve sekondare të së drejtës së BE-së në rast papajtueshmërie.

Prandaj me këtë vendim të GJED u përcaktua detyrueshmëria e Kartës por edhe e efekteve të zbatimit të direktivës 2004/113.

Pra trajtimi i barabartë mes burrave e grave në ofrimin e shërbimeve përveç dispozitave të direktivës ndikohet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë e cila shërben si guide thelbësore pas traktatit, për iliminimin sa më efikas ndaj destinatarëve të së drejtës komunitare.

¹²³Shih: Peripoli.A., *Is the ECJ finally putting the Charter to work?* Association Belge des consommateurs Test-Achats ASBL 236/09, në http://www.academia.edu/2083167/IS_THE_ECJ_FINALY_PUTTING_THE_CHARTER_TO_WORK_-_Association_Belge_des_Consommateurs_Test-Achats_ASBL_C-236_09; Shih: Report on transposition and application of Council Directive 2004/113/EC implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services (2010/2043(INI)) në <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=REPORT&reference=A7-2013-0044&language=EN>;

=====

Referenca

- I. Direktive 2004/113 në Official Journal of the European Union, 21.12.2004
<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:373:0037:0043:en:PDF>
- II. Karta për të Drejtat Themelore në Bashkimin Evropian në tekstin: Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, botim i Ministrisë së Integritetit Evropian, 2008.
- III. Peripoli.A., Is the ECJ finally putting the Charter to work? Association Belge des consommateurs Test-Achats ASBL 236/09,
[http://www.academia.edu/2083167/IS THE ECJ FINALLY PUTTING THE CHARTER TO WORK -Association Belge des Consommateurs Test-Achats ASBL C-236 09;](http://www.academia.edu/2083167/IS_THE_ECJ_FINALLY_PUTTING_THE_CHARTER_TO_WORK_-Association_Belge_des_Consommateurs_Test-Achats_ASBL_C-236_09;)
- IV. Report on transposition and application of Council Directive 2004/113/EC implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services(2010/2043(INI))
[http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=REPORT&reference=A7-2013-0044&language=EN;](http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=REPORT&reference=A7-2013-0044&language=EN)
- V. Test-Achats v. Council of Ministers: [http://en.wikipedia.org/wiki/Test-Achats vs Council of Ministers](http://en.wikipedia.org/wiki/Test-Achats_vs_Council_of_Ministers).
- VI. Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, botim i Ministrisë së Integritetit Evropian, 2008.